



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/112

Datë: 03.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 mars 2010, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në shumën prej 50.000 (pesëdhjetëmijë) euro për organizimin e aktiviteteve, me rastin e shënimit të manifestimin gjithë-popullor "Epopëja e UÇK-ës.
2. Manifestimi gjithë-popullor "Epopëja e UÇK-ës", më 5, 6 dhe 7 mars 2010, organizohet nën patronazhin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës.
3. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë dhe barten në Zyrën e Kryeministrit, kodi 10700, në kategorinë mallra dhe shërbime.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/112
Datë: 03.03.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 mars 2010, mori:

V E N D I M

1. Z. Ylber Hysa emërohet Koordinator i Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e Strategjisë gjithëpërfshirëse për veriun e Kosovës.
2. Koordinatorin është përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve qeveritare, dhe bashkëpunimin me të gjithë mekanizmat relevantë vendorë dhe ndërkombëtarë për zbatimin e strategjisë.
3. Koordinatorin për punën e vet i raporton drejtpërdrejt Kryeministrit.
4. Paga e Koordinatorit do të jetë 1.182.50 euro, ekuivalent me pagën e zëvendësministrave.
5. Shpenzimet për Koordinatorin mbulohen nga Rezervat e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
6. Të gjitha ministratë dhe institucionet vendore obligohen për bashkëpunim dhe përkrahje për zbatimin e Strategjisë gjithëpërfshirëse për veriun e Kosovës.
7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë